



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1367 Prot.

Tiranë, më 06.11 2017

VENDIM Nr. 219, datë 31.10.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.12, datë 31.10.2017, pasi shqyrtoi Konceptin e Sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit "*Ndërtimi i Shkollës 9 vjeçare Marie Kaçulini*", Rruga "*Mujo Ulqinaku*", në zonën arkeologjike "*B*" Durrës- subjekti Bashkia Durrës, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k.

VENDOSI:

1. Të miratojë Konceptin e Sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit "*Ndërtimi i Shkollës 9 vjeçare Marie Kaçulini*", Rruga "*Mujo Ulqinaku*", në zonën arkeologjike "*B*" Durrës- subjekti Bashkia Durrës, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k.
2. Bashkia Durrës duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila do të kryejë sondazhet arkeologjike, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETARI KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al